




Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.110/23
Datë: 04.12.2023

Duke u bazuar në nenin 11 par.1, nenet 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 04.12.2023, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me ndryshimin e kontrollit mbi MidOcean Holdings II dhe indirekt mbi MidOcean Energy LLC nga Aramco Overseas Company B.V dhe EIG Management Company LLC.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, më datë; 16.10.2023, ka pranuar kërkesën për Përqendrim, me Nr. Prot. 485/23-01/H, lidhur me ndryshimin e kontrollit mbi MidOcean Holdings II dhe indirekt mbi MidOcean Energy LLC nga Aramco Overseas Company B.V dhe EIG Management Company LLC.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 08.11.2023
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 13.11.2023

Ne bazuar të Marrëveshjen se Partneritetit të Kufizuar, në lidhje me ndryshimin e kontrollit mbi MidOcean Holdings II dhe Marrëveshjen e Shoqërisë së Kufizuar në

lidhje me kontrollin indirekt mbi MidOcean Energy LLC, të lidhur me datë më 27 shtator 2023 mes shoqërive Aramco Overseas Company B.V., dhe EIG Management Company LLC.

Aramco Overseas Company B.V, kompani me përgjegjësi të kufizuar e inkorporuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Holandës, me adresë regjistruar Scheveningseweg 64, 2517 KX Hagë, Holandë, e regjistruar pranë regjistrimit të biznesit, e cila operohet nga Dhoma Komerciale e Holandës, me numër të regjistrimit 28040948 ("AOC") është kompani e ndërlidhur dhe indirekt nën pronësi të Saudi Arabian Oil Company, një shoqëri aksionare e krijuar me Dekret Mbretëror No. M/8 dated 04/04/1409H, që funksionon në bazë të ligjeve të Mbretërisë të Arabisë Saudite me numër të regjistrimit komercial 2052101150, me adresë të regjistruar në P.O. Box 5000, Dhahran, kodi postal 3131, Mbretëria e Arabisë Saudite ("Saudi Aramco");

EIG Management Company LLC, është kompani investuese nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me adresë të regjistruar në 600 New Hampshire Avenue NW Suita 1200, Washington, Distrikti i Kolumbisë 20037, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e regjistruar pranë US Securities and Exchange Commission me numër të regjistrimit 801-71744, Delaware dhe me numër të regjistrimit biznesit 4832196.

MidOcean Holdings II LP., ortakëri e kufizuar Skoceze, me adresë të regjistruar në Rrugën 50 Lothian Road, Festival Square, Edinburg, EH3 9WJ, Mbretëria e Bashkuar, e regjistruar pranë Shtetësisë së Kompanive në Mbretërinë e Bashkuar me numër të regjistrimit të kompanisë 0131 473 6000.

MidOcean Energy LLC, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e inkorporuar dhe që ekziston bazuar në ligjet e aplikueshme në Delaware, me adresë të regjistruar në, 600

New Hampshire Avenue në, Suita 1200, Washington, Distrikti i Kolumbisë 20037, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e regjistruar në Shtetin Delaware bazuar në Aktin e Shoqërive me përgjegjësi të Kufizuara të Delaware, me numër të regjistrimit 6722887. ("Kompania e Përbashkët e Propozuar")

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b. Qarkullimi i një pale në Përqendrim në tregun e brendshëm ka mbi 1,000,000 Euro.
- c. Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen e Partneritetit të Kufizuar, në lidhje me ndryshimin e kontrollit mbi MidOcean Holdings II dhe Marrëveshjen e Shoqërisë së Kufizuar në lidhje me kontrollin indirekt mbi MidOcean Energy LLC

Analiza e Konkurrencës dhe vlerësimi i konkurrencës

Transaksioni i propozuar është në lidhje me ndryshimin e kontrollit nga i vetmi në të përbashkët mbi MidOcean Holdings II dhe në mënyre indirekte mbi MidOcean Energy LLC., nga Sandi Aramco, nëpërmjet kompanisë së ndërlidhure AOK dhe EKG, Palët në transaksion nuk kanë në planë të jetë aktive në asnjë mënyrë në tregun e Republikës së Kosovës, Transaksioni si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, për më tepër, kompania e përbashkët e propozuar nuk ka prezencë, prandaj tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Tregu përkatës dhe Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu përkatës, mbetet i pandryshuar edhe pas transaksionit

Tregu i produktit, përfshin tregun për kërkime si dhe furnizim me shumicë në rrjedhje e sipër të gazit natyror

Tregu gjeografik, do të përcaktohet si tregu ndërkombëtar, pasi që ka shtrirjeje ndërkombëtare

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik në Mbretërinë e Bashkuar, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se palët në Përqendrim kanë shitje përmes konsumatorëve në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, për arsye se palët nuk do të shtrijë aktivitetin në lidhje me kërkimin e gazit natyror dhe furnizim në Kosovës, prandaj nuk ka mundësi të bëjë ndryshim në strukturën (horizontale apo vertikale) të tregut, sa i përket mbivendosjeve të mundshme horizontale, përqendrimin propozuar nuk implikon mbivendosje të konsiderueshme horizontale.

Ndërmarrjet e përfshira në Përqendrim nuk kanë ndikim në tregun kosovar e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg, për arsye se ndërmarrja e Përbashkët nuk do të jetë e pranishme në tregun e Kosovës.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se transaksioni nuk paraqet efekte negative, në konkurrencë për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominues të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim;

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva